



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
REKTORATI

Nr. 1476/1 Prot.

Vlorë, më, 14.10.2022

**VENDIM**

Nr. 17, datë **14. 10. 2022**

**PËR**

**NDARJEN E MBINGARKESËS MËSIMORE VJETORE, TË PAGUESHME, TË PEDAGOGËVE PËR ÇDO VIT AKADEMIK**

Në mbështetje të Ligjit 80/15 “ Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, të Statutit të Universitetit “Ismail Qemali”, Udhëzimit nr 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, Rektorati në mbledhjen e zhvilluar në datën 14. 10. 2022,

**VENDOSI**

Drejtuesit e Njësive bazë në shpërndarjen e ngarkesës mësimore vjetore, të pagueshme, në çdo vit akademik, për çdo pedagog, të zbatojnë dy rregulla si më poshtë:

1. Mbingarkesa mësimore vjetore, e pagueshme, brenda dhe jashtë auditorit, për secilin pedagog, nuk do të kalojë mbi 300 orë mësimore.
2. Diferenca e ndarjes së mbingarkesës mësimore vjetore, të pagueshme, midis pedagogëve në Njësitë bazë nuk do të kalojë më shumë se 50 orë.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Personeli akademik, Njësitë kryesore, Njësitë bazë, Zv. Rektori Akademik dhe Drejtorja e Edukimit për Ciklin I dhe II.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**REKTORI**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

